



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M
Nr. 8 Datë 05.09.2017

**“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “ EUROBIZNES ” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51, nenit 52, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika f, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, miratimin paraprak Nr. 7055/4, datë 24.12.2015 dhe miratimin përfundimtar Nr.3613/6, datë 10.05.2017 të MEI, për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujqor të subjektit “**EUROBIZNES” SH.P.K.**, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin e lejes së subjektit “**EUROBIZNES sh.p.k.**” me administratore Znj.Anthulla BOÇI, për përdorim të burimit ujqor **Përroi i Mullirit** për prodhim energjie elektrike në Lusën, Njësia Adm. Ujmisht,Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti **HEC LUSNA 2** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes: X – 44 51 260; Y –46 42 744; Z – +1168 m

Koordinatat e godinës së centrali: X – 44 49 384; Y –46 43 126; Z - +810 m;

Koordinatat e pikës së shkarkimit : X – 44 49 384; Y –46 43 126; Z - +810 m;

Prurja mesatare vjetore e burimit : Q mes= 0.078 m³/sek;

Sasia e ujqit që kërkohet të përdoret nga subjekti:

Q llog = Qvepres marrjes (0,02 m³/sek) +Q shkarkimi H/C Lusna1(0.23 m³/sek) = 0,25m³/sek;

Prurja ekologjike: Qekol= 0.017 m³/sek;

Prurja që shkarkohet: Q= 0.25 m³/sek.

2-Leja e përdorimit të burimit ujqor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Martin **PLLUMBI**

KRYETAR

Paulin **RADOVANI**

